



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH Nr. 85/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga Kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, në përbërje prej: z. Ekrem Salihu- Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE “Aritech” sh.p.k - me seli në Livagje, kundër Njoftimit për dhënien e kontratës të datës 07.03.2017, nga ana e autoritetit kontraktues (AK) – Akademia e Kosovës për Siguri Publike (ASKP), lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me kompjuter”, me nr. të Prokurimit: 214/17/04/136, me datë: 20.04.2017- konform nenit 28.par 1 të rregullores së punës së OSHP-së, mori këtë :

V E N D I M

I. REFUZOHET, si e pabazuar- ankesa OE. “Aritech” sh.p.k, me seli në Livagje, kundër Njoftimit për dhënien të kontratës të datës 07.03.2017, lidhur me procedurën e prokurimit me titull: “Furnizim me kompjuter”, me nr. të Prokurimit: 214/17/04/136, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Akademia e Kosovës për Siguri Publike (ASKP).

II. APROVOHET, vendimi i Autoritetit Kontraktues (AK) – Akademia e Kosovës për Siguri Publike (ASKP), Njoftimi për dhënien e kontratës, lidhur me procedurën e prokurimit me titull “Furnizim me kompjuter”, me nr. të Prokurimit: 214/17/04/136, si i bazuar.

III. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së Nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues, që nuk respekton vendimin e Panelit shqyrtues të paraparë me këtë ligj.

Autoriteti Kontraktues në aftë prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë prokurim .

IV.Meqenëse pretendimet ankimore të operatoreve ekonomik ankues “Aritech” sh.p.k – Livagje, janë të pa qëndrueshme, konform nenit 118 të LPP-së, të njëjtit i konfiskohet sigurimi i ankesës.

ARSYETIM

Autoriteti kontraktues më dt.14.02.2017 ka bërë publikimin e njoftimit për kontratë ,lidhur me procedurën e prokurimit me titull: “Furnizim me kompjuter”, me nr. Prokurimi 214/17/04/136

Autoriteti kontraktues më dt.07.03.2017 ka bërë publikimin e njoftimit për dhënje të kontratës në web-faqe të Krpp-së.

Operatori Ekonom “Aritech”sh.p.k, si palë e pa-kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP me dt: 24.03.2017, kundër Njoftimit për dhënien e kontratës të datës 07.03.2017, duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Nr.05/L-092, siç janë: Neni 7 të LPP-së.

Ankesa është e pabazuar dhe e njëjta është e afatshme dhe është parashtruar nga ana e personit kompetent.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113.1 të LPP-së Nr. 04/L-042, ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të shqyrtuar procedurën e zhvilluar lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të pales ankimore, të OE “Aritech”sh.p.k, me seli në Livagje.

OE. ankues “Aritech”sh.p.k – Livagje, me datë 07.04.2017, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se NUK PAJTOHET me mendimin e ekspertit shqyrtues të dt: 07.04.2017 pa ofruar asnjë provë konkrete për arsyet e mospajtitimit.

Autoriteti kontraktues, nuk ka ndonjë përgjigje në raportin ekspertizes, edhe pse i njëjti ka qenë i njoftuar me kohë me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues vendosi që seanca të mbahet pa pranin e paleve të përfshira në procedur konform nenit 28, par.1 të Rregullores së punës të OSHP-së.

Paneli shqyrtues konstatoi, se NUK qëndron pretendimi ankimor i ankuesit sa i përket garancionit në lidhje me produktin nr.1” Laptop Core I5”, OE. i rekomanduar për kontrat në harmoni me kërkesën e FDT-së pika 7, ka ofruar garancion 1 vjeqar me shkrim i volusor dhe nënshkruar nga ana e OE. të rekomanduar për kontrat. Njëherit OE. i rekomanduar për kontratë ka ofruar garancion konform kërkesës së FDT-së.

Paneli shqyrtues konstatoi sa i përket specifimit teknik për produktin nr. 2, kompjuter personal (shtëpizë), në kërkesën e dosjes tek specifikimit teknik është kërkuar që form factor të jetë” MIDI TOWER” ose “TOWER”, ndërsa OE. i rekomanduar për kontrat në ofertën e tij ka ofruar duke përshkruar specifikimin” MIDI TOWER” që është në harmoni me specifikimin teknik, ndërsa sa i përket pretendimit ankimor se i njëjti OE. fitues nuk mundet të furnizoj këtë produkt sipas përshkrimit teknik, paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues është i obliguar që gjatë implementimit të kontrates të ketë parasysh specifikimin teknik gjatë pranimit të këtyre

produkteve, dhe kjo është një fazë tjetër e cila ka të bëjë me implementimin e kontratës.

Poashtu paneli shqyrtues konstaton se ankuesi nuk ka ofruar asnjë provë me shkrim për të demantuar autoritetin kontraktues lidhur me shkaqet e eliminimit të tij për shkak të mospërbushjes së specifikave të detyrueshme të kërkuara nga ana e autoritetit kontraktues dhe se i njëjti nuk ka aritur të dëshmojë interes juridiko-material konform nenit 111 par.1 prej pikës 1 gjer 8 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konstatoi, se NUK qëndron pretendimi ankimor në lidhje me shkeljen e nenit 7 të LPP-së, për faktin se kriteret e dosjes NUK kanë qenë diskriminuese, duke u bazuar në atë se asnjë nga OE. pjesëmarrës NUK kanë parashtruar ankes në lidhje me kriteret e dosjes gjatë fazës tenderuese , poashtu gjatë vlerësimit të ofertave AK-ja ka bërë trajtimin të barabart të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit në harmoni me nenin 7 të LPP-së.

Andaj, paneli shqyrtues, duke u bazuar në nenin:117 të LPP-së dhe atë që u tha si më lartë, vendosi që të ia fal besimin raportit të ekspertit shqyrtues të dt.07.04.2017 dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike :

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur nuk mundë të ushtron ankesë, por për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh, pas pranimit të këtij vendimi, mund të ngritë kërkesëpadi në Departamentin për çështje administrativ pranë Gjykatës Themelore.

Vendimi t'i dorëzohet:

1. 1x1 AK – “ASKP”.
2. 1x1 OE “Aritech”sh.p.k.
3. 1x1 Arkivës së OSHP-së

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Ekrem Salihu

